

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjyquese, Luljete Shabani, me praktikantin Naser Sejdiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.N. nga Gjilani, për shkak të veprës penale **Shpërdorimi i pasurisë së huaj**, nga neni 330 par. 1, të **KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 1852/2017, të datës 31.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 24.10.2018, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 21.11.2018, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.N., nga babai Sh. dhe nëna T., e lindur S., i lindur më datë ... në Gjilan, ndërsa jeton në fshatin ..., K. e Gjilanit, i pa martuar, punon si kamarier në Resturant “ ... ” në Gjilan, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, më datën 09.08.2017, rreth orës 19:00 minuta, në Resturantin “Vali Ranch” në f.sh. Përlepnicë. K. Gjilan, i pandehuri A.N., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasuror për vete apo personin tjetër, para përfundimit të orarit të punës, pa lajmruar akënd dhe pa lejen e askujt është larguar nga vendi i punës duke marrë shumën e të hollave në vlerë prej 666,1 euro, nga pazari ditorë i shërbimit si kamarier, kështu që i pandehuri me veprimet e veta, të dëmtuarës “Vali Ranch” i ka shkaktuar dëm më vlerën e lartëshënuar.

-me çka ka kryer veprën penale, **Shpërdorimi i pasurisë së huaj**, nga neni 330 par. 1 të **KPRK-së**, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 51, 73, 114 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit A.N., me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh** dhe **Dënim Gjobe**, në shumën prej **150 (njëqindpesëdhjetë) €**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (një) viti**, nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohet i akuzuari që të paguaj **paushallin gjyqësor** në shumën prej **15 (pesëmbëdhjetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar udhëzohet në kontest juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr. 1852/2017, të datës 31.10.2017, kundër të akuzuarit A.N., për shkak të veprës penale, Shpërdorimi i pasurisë së huaj, nga neni 330 par. 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, erdhi në përfundim se i akuzuari A.N. e ka kryer veprën penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj, nga neni 330 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar vullnetarisht, pa presion fajësinë, pas njoftimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë, pati sjellje të mira në Gjykatë, pendimi i tij, si dhe premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 par. 4 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 1166/2017, më datë 21.11.2018

Praktikanti,
Naser Sejdiu

Gjykatësja e vetme gjyquese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.